

VENDIM
Nr. 15, datë 21.1.2000

PËR NJË SHITESË NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2000, PËR MINISTRINË E
BUJQËSISË DHE USHQIMIT, PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS SË KRIJUAR NGA
STUHIA DETARE NË RRETHIN E LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21, të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2000, i shtohen 10 (dhjetë) milionë lekë, për përballimin e situatës së krijuar nga stuhia detare në rrethin e Lezhës.
Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
2. Punimet të kryhen nga Drejtoria e Ujërave, Lezhë.
3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta